Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Elfrida Zefi emërohet prefekt i qarkut të Korçës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.626, datë 3.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Qamil Cenalia emërohet prefekt i qarkut të Kukësit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.627, datë 3.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Xhafer Seiti emërohet prefekt i qarkut të Dibrës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.628, datë 3.10.2005**

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Z.Irakli Koçollari, inspektor i përgjithshëm i Shërbimit Informativ të Shtetit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Saimir Kodra emërohet inspektor i përgjithshëm i Shërbimit Informativ të Shtetit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.629, datë 3.10.2005**

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Marjeta Zaçe emërohet Zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.633, datë 11.10.2005**

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Suzana Turku emërohet Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.634, datë 11.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Roland Bejko emërohet prefekt i qarkut të Beratit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.635, datë 11.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Kreshnik Alimerko emërohet prefekt i qarkut të Vlorës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.636, datë 11.10.2005

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 pika 4 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryekomisar Dashnor Kaja, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për menaxhimin operacional, lirohet nga kjo detyrë.

2. Kryekomisar Ahmet Haxhij, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për menaxhimin e burimeve ndihmëse dhe mbështetëse, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për menaxhimin operacional.

3. Kryekomisar Arben Doçi emërohet Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për menaxhimin e burimeve ndihmëse dhe mbështetëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.637, datë 11.10.2005

PËR CAKTIMIN E TRE ANËTARËVE TË KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 7870, datë 13.4.1994 “ Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin anëtar në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të personave të mëposhtëm:

a) z. Aleksandër Sallabanda, zëvendës ministër i Shëndetësisë, si përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë.

b) z. Sybi Hida, drejtor i analizave dhe politikave buxhetore, në Drejtorinë e Buxhetit, si përfaqësues i Ministrisë së Financave.

c) z. Astrit Kuka, drejtor i Drejtorisë së Pagave dhe Pensioneve, si përfaqësues i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Vendimi nr. 590, datë 22.12.1997 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.646, datë 17.10.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 557, DATË 3.8.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË VARËSISË STRUKTURE, ORGANIKËS DHE TË NUMRIT LIMIT TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “ Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Skema “Struktura dhe përbërja organike e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 557, datë 3.8. 2005 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me “Skema nr.2” që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.650, datë 17.10.2005

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Iva Zajmi emërohet Zëvendësministër i Brendshëm.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.651, datë 17.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “ Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Shahin Bejdaj emërohet prefekt i qarkut të Fierit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.652, datë 17.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “ Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Spiro Ksera emërohet prefekt i qarkut të Gjirokastrës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.654, datë 17.10.2005

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PËRFAQËSUESIT TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NË GRUPIN MBIKËQYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “ Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Farudin Arapi, anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Nexhat Veipi emërohet anëtar, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, në grupin mbikëqyrës të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 657, datë 17.10.2005

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMET NR.280, DATË 16.4.2004 “PËR
NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË
DURRËSIT” DHE NR.283, DATË 16.4.2004 “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË
ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË LEZHËS”, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, SI
DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.284, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRARVE “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË
KULLIMIT KRUIJË-KURBIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

A. Në vendimin nr.280, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

**“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT
DURRËS-KRUIJË”.**

2. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Durrës-Krujë, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “f” të pikës 2 të shtohen shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i”, “j”, “k” e “l” me këtë përmbajtje:

“g) zona e fushës, që kullon me KUL, Thumanë-Borizonë (KRK-1, KRK-2), me sipërfaqe 2130 ha;

gj) zona e kënetës Borizanë-Thumanë (KRK-3), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 1591 ha;

h) zona e fushës, që kullon me përroin Bardharë (KRK-4), me sipërfaqe 1499 ha;

i) zona e fushës Bacung-Dollakë- Tapizë (KRK-5, KRK-6), me sipërfaqe 3714 ha;

j) zona e fushës Bubq-Mallkuc (KRK-7), me sipërfaqe 2567;

k) pendet mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

l) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1(një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

c. 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1(një) përfaqësues nga komunat, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

ç)1(një) përfaqësues i bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1(një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës.”.

B. Në vendimin nr. 283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT LEZHË-KURBIN”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Lezhë-Kurbin, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “e” të pikës 2 të shtohen shkronjat “ë”, “f”, “g”, “gj” e “h”, me këtë përmbajtje:

“ë) zona e fushës së Thumanës (LAK-1), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 8 310 ha;

f) zona e fushës, që kullon me KUL, Gjormë –Zhejë, Mamurras-Lumi Drojë dhe , KUL, Laç-Milot (LAK-2, LAK-3, LAK-4), me sipërfaqe 1193;

g) zona e fushës, që kullon me KK-1, Shullaz-Fusahë, Milot-Gramëz-ALK (LAK-5), me sipërfaqe 1459 ha;

gj) pendet mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

h) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2(dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonë së shërbimit të kullimit të Kurbin;

c) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbin;

ç) 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbin.”.

5. Në vendimet nr.280, datë 16.4.2004 dhe nr.283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit” të zëvendësohet me “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

6. Vendimi nr.284, datë 16.4.2004 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.663, datë 26.10.2005

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 “ Për prefektin”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Mimoza Hasekiu emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.665, datë 26.10.2005

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Florent Çeliku emërohet Zëvendësministër i Punëve të Jashtme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.689, datë 8.11.2005

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË

Në mbështetje të neneve 95 pika 2, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Z. Frrok Çupi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, lirohet nga kjo detyrë.
2.z. Edi Paloka emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.692, datë 10. 11.2005

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË RIPUNUAR “KONSOLIDIMI I NJË SISTEMI
PLANIFIKIMI TË INTEGRUAR NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2.Krijimin e komitetit ndërministror të planifikimit strategjik, të kryesuar nga Kryeministri, për:
-miratimin e drejtimeve kryesore të strategjisë së zhvillimit të vendit;
-përcaktimin dhe miratimin e prioriteteve të qeverisë;
-përcaktimin dhe miratimin e kornizës së planifikimit të borxhit afatmesëm;
-përcaktimin strategjik të taveve buxhetore, në funksion të prioriteteve të qeverisë;
-bashkërendimin strategjik të ndihmës së huaj me komunitetin e donatorëve.
3. Krijimin e komitetit ndërministror të modernizimit të qeverisë, të kryesuar nga zëvendëskryeministri, për:
-sigurimin e procesit teknik të përgatitjes së dokumentacionit të strategjisë kombëtare dhe të bashkërendimit të strategjisë me donatorët;

-sigurimin e bashkërendimit efektiv të programit të modernizimit të qeverisë;
-sigurimin e ngritjes së kapaciteteve dhe të strukturave, në përputhje me rekomandimet e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”.

4.Përbërja e komitetit ndërministror të planifikimit strategjik dhe e komitetit ndërministror të modernizimit të qeverisë të përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

5.Procesi teknik i bashkërendimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, i hartimit të strategjisë së asistencës së huaj e bashkërendimit me programet e donatorëve dhe i zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar të kryhet nga strukturat përgjegjëse në Këshillin e Ministrave.

6.Funksionet e investimeve publike, përfshirë edhe ato të asistencës së huaj, të kryhen nga Ministria e Financave.

7. Vendimi nr. 244, datë 21.4.2005 i Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar”” dhe çdo normë që bie ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.732, datë 23.11.2005

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Lirimin nga detyra të z. Petrit Ruka, kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

2.Emërimin e z. Xhevdet Ferri, kryetar të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.748, datë 9.12.2005

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË MALLRAVE REZERVË SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “ë” e 8, shkronja “h” të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” , me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore me fondin prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, të realizojë blerjen e artikujve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për krijimin e fondit të mallrave rezervë shtetërore.

2. Ky fond të përballohet nga llogaria rrjedhëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore.

3.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore të bëjë shpërndarjen e artikujve, sipas përcaktimeve të Ministrisë së Brendshme.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr	Artikujt	Njësia e matjes	Sasia
I	Artikujt për përdorim të menjëhershëm		
1	Miell	ton	800
2	Oriz	ton	80
3	Sheqer	ton	80
4	Makarona	ton	70
5	Vaj ushqimor	ton	50
6	Fasule	ton	50
7	Konserva perime	ton	30
8	Konserva mishi	ton	10
9	Kripë	ton	5
10	Sapun	copë	30 000
11	Detergjent	ton	30

VENDIM
Nr.753, datë 6.12.2005

PËR DHËNIE FONDI NDIHME REPUBLIKËS ISLAMIKE TË PAKISTANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të nenit 6 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr. 9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Republikës Islamike të Pakistanit t’i jepet fondi prej 5 210 000 (pesë milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekësh, si ndihmë financiare për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 8 tetor 2005.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
- 3.Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.758, datë 6.12.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1997 “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT/KOMPONENTI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 1997 “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit/komponenti i furnizimit me ujë të pijshëm”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1997 PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT- KOMPONENTI I FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, *Në frymën* e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

Duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë,

Të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

Me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

Duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 2 dhjetor 2004 dhe bisedave të punës të datës 16 mars 2005,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja palët kontraktuese, të marrin nga Kreditanstalt Fur Wiederaufbau (KFW), Frankfurt mbi Majn, një hua me vlef të prej gjithsej 4 882 837,47 EUR (me fjalë: katër milionë e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë euro e dyzet e shtatë cent) për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit-komponenti i furnizimit me ujë të pijshëm”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në qoftë se projekti i përmendur në paragrafin 1 do të zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, si projekt i mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose si fond garantues të kredive për ndërmarrje të mesme, ose si masë e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, ose si masë, e cila synon luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëdihmës, atëherë mund të jepet një shumë financimi, përndryshe mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma financimi dhe masat të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 2, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohej midis Kreditanstalt fur Wiederaufbau dhe huamarrësit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet në rast se kontrata përkatëse për hua nuk përfundohej brenda një afati prej 8 vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron në datë 31 dhjetor 2005.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditanstalt fur Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro, për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratës, e cila do të përfundohej sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 14.11.2005 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.759, datë 6.12.2005

PËR VLEFSHMËRINË E MARRËVESHJEVE DYPALËSHE, TË NËNSHKRUARA NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË ISH-REPUBLIKËS ÇEKE E SLLOVAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Njohjen si të vlefshme, në marrëdhëniet dypalëshe, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe, të marrëveshjeve dypalëshe, të nënshkruara në nivel ndërshtetëror ose ndërqeveritar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së ish-Republikës Çeke e Sllovaqe, të parashikuara në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Marrëveshjet dypalëshe, të përmendura në aneksin nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, kanë mbaruar vlefshmërinë e tyre ose kanë humbur qëllimin, për të cilin ato janë përfunduar, shfuqizohen në marrëdhëniet e ndërsjella, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1

Marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Çeke dhe Sllovaqe, të cilat qëndrojnë në fuqi në marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Sllovaqe.

1.Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ish-Republikës së Çekosllovakisë mbi bashkëpunimin kulturor (Tiranë, 1 dhjetor 1952).

2.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi transportin ajror (Tiranë, 30 maj 1958).

3.Konventë konsullore ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës së Çekosllovakisë (Tiranë, 16 janar 1959).

4.Marrëveshja ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës së Çekosllovakisë mbi ndihmën për çështjet civile, familjare dhe penale (Pragë, më 16 janar 1959).

5.Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së

Republikës së Çekosllovakisë mbi transportin ndërkombëtar rrugor (Pragë, më 7 janar, 1991).

6. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit (Pragë, më 26 nëntor 1991 dhe Tiranë, më 30 nëntor 1991).

Aneksi nr.2

Marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Çeke dhe Slloake, të cilat shfuqizohen në marrëdhëniet reciproke ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Slloake.

1. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë për dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Pragë, 8 shkurt 1956).

2. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Pragë, 8 shkurt 1956).

3. Shtesa e parë e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë të 8 shkurtit 1956 (Tiranë, më 4 qershor 1956).

4. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi kredinë për furnizimin me mallra nga Republika e Çekosllovakisë për Republikën Popullore të Shqipërisë në periudhën 1956-1960 (Pragë, 5 gusht 1957).

5. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin e depozitave të hekur-nikelit në Pishkash- rajoni lindor i Republikës Popullore të Shqipërisë (Tiranë, më 5 maj 1958).

6. Shtesa e dytë e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë (Tiranë, më 5 maj 1958).

7. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi postat, telegraf dhe telefon-komunikacionin (Pragë, më 23 shtator 1959).

8. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në çështjet doganore (Tiranë, më 17 tetor 1960).

9. Shtojca e shtesës së dytë të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi dhënien e kredisë për eksportimin dhe përdorimin e depozitave të hekur-nikelit në rajonin e Elbasan-Pishkash-Pogradec të Republikës Popullore të Shqipërisë të shkurtit 1956, nënshkruar në maj 1958 mbi vlerësimin e kobaltit në hekur-nikelin ose shpërndarjen nga Republika Popullore e Shqipërisë në Republikën Socialiste të Çekosllovakisë (Tiranë, më 3 tetor 1973).

10. Protokollin ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekosllovakisë mbi rregullimin e kursit reciprok të këmbimit ndërmjet koronës çekosllloake dhe lekut shqiptar në pagesat jotregtare (Tiranë, më 2 nëntor 1983).

11. Protokollin ndërmjet Ministrisë së Tregtisë së Jashtme të Republikës Popullore të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale të Tregtisë së Jashtme të Republikës Socialiste të Çekosllovakisë mbi kushtet e shpërndarjes së mallrave dhe pagesave ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare për tregtinë e huaj dhe organizatave çekosllloake të autorizuara për ushtrimin e aktivitetit të tregtisë së huaj (Tiranë, më 6 prill 1987).

12. Protokollin ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Çeke dhe Slloake mbi rregullimin e detyrimeve reciproke në marrëdhëniet e pagesave deri më 31 dhjetor 1991 (Tiranë, më 23 janar 1992).

13. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale Çeke dhe Slloake mbi pagesat tregtare reciproke deri më 1 janar 1992 (Tiranë, më 23 janar 1992).

14. Marrëveshja nënshkruar me shkëmbim notash mbi vendosjen e regjimit të vizave ndërmjet

Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Çekosllovaqe (Tiranë, më 5 dhjetor 1961, Pragë, më 9 dhjetor 1961).

VENDIM
Nr.764, datë 6.12.2005

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË KRYETARIT TË KËSHILLIT TË
AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Lirimin nga detyra të znj. Burbuqe Riba, kryetar i Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.
2. Emërimin e z. Asllan Shera kryetar i Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.780, datë 14.12.2005

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Znj. Edith Harxhi emërohet Zëvendësministër i Punëve të Jashtme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.781, datë 14.12.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.VESSEL AHMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Vesel Ahmeti, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.
2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.793, datë 16.12.2005

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ.MELPOMENI SHTETO
(ZORAQI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj.Melpomeni Shteto (Zoraqi), në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.
2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.832, datë 28.12.2005

PËR DHËNIEN E NJË SHPËRBLIMI TË MENJËHERSHËM, SI NDIHMË PËR FESTIMIN E
VITIT TË RI, NËNAVE ME TRE APO MË SHUMË FËMIJË, TË LINDUR NJËHERËSH, TË
CILËT NUK KANË FILLUAR ARSIMIN E DETYRUESHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr. 9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Dhënien e një shpërblimi të menjëherëshëm, si ndihmë për festimin e Vitit të Ri, në masën 5000 (pesë mijë) lekë, për çdo fëmijë, nënave me tre apo më shumë fëmijë, të lindur njëherësh, të cilët nuk kanë filluar arsimin e detyrueshëm.
2. Fondi prej 1 000 000(një milion) lekësh, i llogaritur për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.833, datë 28.12.2005

**PËR MIRATIMN E LIRIMIT NGA DETYRA TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS, Z SOKOL KRAJA, DHE TË EMËRIMIT NË KËTË
DETYRË TË Z. THOMA MIÇO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e lirimit të z. Sokol Kraja nga detyra e inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

2. Miratimin e emërimit të z. Thoma Miço në detyrën e inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**VENDIM
Nr.836, datë 28.12.2005**

**PËR PAGESËN E DIFERENCAVE TË PENSIONEVE PËR PERSONAT, QË PËRFITOJNË NGA
LIGJI NR.7514, DATË 30.9.1991 “PËR PAFAJËSINË, AMNISTINË DHE REHABILITIMIN E
ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Likuidimin e shumave dhe të diferencave të pensioneve, për periudhat e kaluara, për personat, që përfitojnë nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, të llogaritura në shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga fondet e programuara në buxhetin e vitit 2005, zëri “Financime për programe të tjera”, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**VENDIM
Nr.843, datë 30.12.2005**

PËR SHKARKIMIN E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRISË “VEFA” NË ADMINISTRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7/8 të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Z. Nasip Ahmeti dhe z. Saba Duckollari, administratorë të shoqërisë “Vefa”, në administrim, shkarkohen nga detyra e administratorit.

2. Ngarkohet grupi mbikëqyrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë